REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Njoftim për aplikim
2018-04-03 09:16:00

Iniciativa e kërkimit shkencor për ekspertë të arteve marciale nga qendra ndërkombëtare e arteve marciale për zhvillimin dhe angazhimin e të rinjve 2018

Qendra Ndërkombëtare e Arteve Marciale për zhvillimin dhe angazhimin e të rinjve do të organizojë takimin e dytë të ekspertëve të kërkimit të Arteve Marciale e cila do të mbahet nga data 2 Korrik deri më 20 Gusht 2018 në Chungju, Republika e Koresë. Ky takim synon inkurajimin e instruktorëve te arteve marciale në ndërtimin e kapaciteteve për të përcjellë vlera pozitive të arteve marciale për të rinjtë dhe gratë.

Aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- Të jetë njohës i gjuhës angleze (të folur dhe të shkruar);
- Pjesëmarrësit duhet të jenë midis moshës 23 dhe 35 vjeç dhe të zotërojnë diplomën bachelor;
- Të jetë praktikues i arteve marciale dhe të ketë minimumi dy vite përvojë; (veçanërisht për të rinjtë dhe gratë)

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

1. **Formati i aplikimit sipas aneksit II bashkëlidhur**;
2. Letër reference (të miratuar nga një person i autorizuar nga Komisioni Kombëtar i UNESCOS-s ose institucioneve të lidhura);
3. Curriculum Vitae;
4. Certifikata ose dokumente mbi aktivitetet e aplikantit që dëshmojnë kualifikimet në artet marciale;
5. Fotokopje të pasaportës.

Mbulimi Financiar:

1. Fluturimi ndërkombëtar (ekonomik);
2. Vendi i akomodimit (Chungju, Republika e Koresë);
3. Shpenzimet e trajnimit;
4. Sigurimi shëndetësor;
5. Kontroll i shkurtër mjekësor për të vlerësuar gjendjen fizike të pjesëmarrësit;
6. Shpenzimet e jetesës 35,000 KRW (në ditë)

Afati për aplikim: Datë 13 Prill 2018
Adresa: **unesco.al@mfa.gov.al**